VENDIM
Nr.374, datë 27.3.2008

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURISË SË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, E CILA PREKET NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR "URA LIDHËSE, LEZHË"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 e 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik", dhe të nenit 8 të ligjit nr.9464, datë 28.12.2005 "Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2006", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurisë së paluajtshme, pronë private, që preket nga ndërtimi i segmentit rrugor "Ura lidhëse, Lezhë".".
2. Shpronësimi të bëhet në favor të Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve.
3. Pronarët e pasurisë së paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, pjesë përbërëse e tij, për sipërfaqen 12 078 m^2 tokë arë, e vlerësuar me 427 lekë/m^2, për jonxhë dhe kultura drufrutore, me vlerë të përgjithshme shpronësimi 7 236 904 (shtatë milionë e dyqind e tridhjetë e gjashtë mijë e nëntëqind e katër) lekë.
4. Shpenzimet procedurale, në shumën 305 000 (treqind e pesë mijë) lekë, të përballohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve.
5. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 7 236 904 (shtatë milionë e dyqind e tridhjetë e gjashtë mijë e nëntëqind e katër) lekësh, të përballohet nga llogaria e veçantë e Ministrisë së Financave "Fondi i shpronësimeve", pranë Bankës së Shqipërisë.
6. Shpronësimi dhe likuidimi i pronarëve të bëhen nga Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe të përfundojnë deri më 1.6.2008.
7. Pronarët e përmendur në listën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, për të cilët është bërë shënimi "Plotësim dokumentacioni", të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin e pronësisë pranë subjektit kërkues, Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve.
8. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit dhe Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

LISTA E PRONARËVE, TË CILËT DO TË SHPRONËSOHEN, SI REZULTAT I NDËRTIMIT TË RRUGËS LIDHËSE, LEZHË

Nr.	Emri	Atësia	Mbiemri	Z.Kadas	Nr.pas	Sip/m^2	Çmimi tokë/arë	Vlera/lekë	Çmimi jonxhë lek/m^2	Vlera kultura bujq/lekë	Vlera dru frut/lekë	Totali/lekë	Shënime
1	Katerina	Pjetër	Lekaj	1986	52/3	534	427	228 018				228018	Plot.dok
2	Shtjefën	Fran	Lekaj	1986	52/7	2030	427	866 810	27	54 810	377 000	1298 620	Plot.dok
3	Pashk	Gjon	Lekaj	1986	52/9	850	427	362 950	27	22 950	122 000	507 900	Plot.dok
4	Zef	Pashk	Lekaj	1986	52/10	850	427	362 950			116 000	478 950	Plot.dok
5	Vasil	Prek	Lekaj	1986	52/13	675	427	288 225				288 225	Plot.dok
6	Luigj	Prek	Loshi	1986	52/14	675	427	288 225			162 000	450 225	Plot.dok
7	Ndue	Zef	Leka	1986	52/15	1202	427	513 254	27	32 454		545 708	Plot.dok
8	Luigj	Martin	Lekaj	1986	52/16	926	427	395 402	27	25 002		420 404	Plot.dok
9	Losh	Lek	Lekaj	1986	52/18	406	427	173 362	27	10 962		184 324	Plot.dok
10	Prendaqe	Kol	Lekaj	1986	52/19	375	427	160 125				160 125	Plot.dok
11	Ndue	Gjergj	Lekaj	1986	52/20	375	427	160 125			22 000	182 125	Plot.dok
12	Gjok	Pjetër	Lekaj	1986	49/5	860	427	367 220	27	23 220	191 500	581 940	Plot.dok
13	Luigj	Prek	Loshi	1986	49/1	220	427	93 940				93 940	Plot.dok
14	Ndue	Zef	Leka	1986	49/2	560	427	239 120	27	15 120	358 000	612 240	Plot.dok
15	Luigj	Martin	Lekaj	1986	49/3	840	427	358 680	27	22 680	305 000	686 360	Plot.dok
16	Losh	Lek	Lekaj	1986	49/4	700	427	298 900	27	18 900	200 000	517 800	Plot.dok
	Shuma					12078		5 157 306		226 098	1 853 500	7 236 904	

Vlera totale e shpronësimit është 7 236 904 (shtatë milionë e dyqind e tridhjetë e gjashtë mijë e nëntëqind e katër) lekë.